



Nr. 80 Viti i tetë i botimit Janar 2020

Në këtë numër do të gjeni:

- Aksione Komunitare për Zonat e Mbrojtura
- Censusi ndërkombëtar i shpendëve të ujit 2020
- 26 Janari - Dita Botërore e Edukimi Mjedisor
- 27 Janari - Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar
- ...pak histori...
- Njoftime

Aksione Komunitare në Zonat e Mbrojtura


Vazhdojnë aktivitetet në kuadër të projektit ACAP - Aksione Komunitare në Zonat e Mbrojtura. INCA në bashkëpunim me Shkollën "Hasan Mëhilli" Dukat - Vlorë, e cila ndodhet pranë Parkut Kombëtar Llogara, si dhe me mbështetjen e Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Vlorë, realizuan një orë edukative me temë mësimore "Pasuritë floristike

dhe faunistike të vendit tonë si dhe dëmtimi i tyre".

Të kujdesesh për natyrën, nis që me ambientin e shkollës duke dhënë sadopak kontribut në gjallërimin dhe shëndetin e biodiversitetit që ndodhet aty. Për këtë arsye kjo orë u shoqërua me lyerjen e trungjeve të pemëve si një mënyrë për të mbrojtur bimët nga ngrica, sidomos për një zonë e cila është mjaft e prekshme nga erët e ftohta siç është edhe Dukati

Vijon në faqe 2





Vijon nga faqe 1 Në kuadër të thirrjes "Thirrje shkollave për veprim" të projektit ACAP, shkolla "Hasan Mëhilli" Dukat, Vlorë, ka qenë fituese e një miniprojekti i cili ka filluar të zbatohet këtë vit duke nisur me aktivitete informimi për krijimin e një fidanishteje në ambientet e shkollës, e cila do të shërbejë si një oaz organizmash dhe si laborator i hapur në natyrë për orët mësimore.



Ky projekt titullohet "Fëmijët për pyllin e Llogara-së", pasi çdo bimë e mbjellë në parcelë, do të jetë pjesë shëmbëllyese e pasurisë bimore të këtij parku.

Shkolla Balil Pelari - Orikum, Vlorë, mbylli me sukses projektin e titulluar "Parcela ime" i cili konsistonte në mbjelljen e një parcele në PK Llogara dhe kujdesjen për këtë parcelë nga nxënësit e shkollës.

Ky aktivitet u zhvillua me mbështetjen e INCA në kuadër të projektit ACAP Project-Azione Comunitaria per le Aree Protette dell'Albania.



Censusi ndërkombëtar i shpendëve të ujit 2020

INCA iu bashkua edhe këtë vit Censurit Ndërkombëtar të shpendëve të ujit 2020, që konsiston në numërimin e shpendëve dimërues të ujit në të gjithë Shqipërinë brenda 3 ditëve, me shpërndarjen e ekspertëve, administratës dhe vullnetarëve në 25 ligatina.

Në datat 10, 11 dhe 12 Janar 2020, u zhvillua Censusi Ndërkombëtar i Shpendëve Ujorë, ku u angazhuan edhe këtë vit stafi i AdZM-ve rajonale, organizata mjedisore, ekspertë dhe vullnetarë e dashamirës të shpendëve. INCA me ekspertët e saj, ishte dhe këtë vit pjesë e numërimit, duke mbuluar zonat e Liqenit të Banjës, liqenet e Belshit, Rezervuari i Thanës, Grykëderdhje e Semanit, Karpen, laguna e Nartës, laguna e Orikumit, Laguna e Butrintit, Syri i Kaltër dhe rezervuari i Bulos. Në të gjitha këto pika jemi shoqëruar nga ekspertët dhe nga stafet i AdZM Elbasan, AdZM Berat, AdZM Tiranë dhe AdZM Vlorë.



...PAK HISTORI...

...7 vjet më parë ...

...VKM nr. 221, datë 20.02.2013 "Për caktimin e zonave të brezit të gjelbër të qytetit të Tiranës dhe të rrethinave të tij", në mbështetje të neneve 3, 20/3

dhe 23 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2001 "Për mbrojtjen mjedisit", të ndryshuar dhe pikës 4, të nenit 27 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 "Përplanifikimin e territorit", të ndryshuar...

...8 vjet më parë ...

...VKM nr.134, datë 20.02.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.693, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar".

Me këtë VKM janë saktësuar kufijtë e parkut kombëtar të Butrintit, sipërfaqet e përdorimit të territorit...; ndryshohet pika 4 në lidhje me zonimin e territorit dhe pika 6 ndryshohet si më poshtë: Ngarkohen zyra e administrimit dhe koordinimit të PK

të Butrintit, në varësi të MTKRS, administrata e PK, në varësi të MMPAU dhe Komiteti i Menaxhimit të këtij parku, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojnë menaxhimin e parkut dhe të kontrollojnë zbatimin e planit të menaxhimit të PK. Shtohet pika 5.1, kundër të tjera theksohet që MMPAU, MTKRS dhe ministritë e tjera të linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore të rishikojnë lejet që kanë dhënë për veprimtari ekonomike e shoqërore brënda sipërfaqes së PK Butrint...

...15 vjet më parë ...

...me VKM nr.86, datë 11.02.2005 për "Krijimin e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura", në

zbatim të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr.8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar...

...21 vjet më parë ...

...territori natyror i zonës së Prespës së Madhe dhe i Prespës së Vogël, me sipërfaqe të përgjithshme 27,750.0 ha, me VKM nr.80, datë 18.02.1999, shpallet "Park Kombëtar", përfshihet në qarkun e Korçës dhe në rrethet Korçë dhe Devoll. Brenda këtij territori është përfshirë (duke ndërruar dhe statusin) edhe sipërfaqja e ish rezervatit të gjuetisë "Gorricë", me sipërfaqe 18,150.0 ha, miratur me urdhër të ish

Ministritë së Bujqësisë, në vitin 1957.

Pjesë e territorit të Parkut Kombëtar "Prespa", gëzon edhe statusin e Zonës RAMSAR, sipas VKM nr.489, datë 13.06.2013, me sipërfaqe 15,118.6 ha.

Me VKM nr. 80, datë 18.02.1999, territori natyror i pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit, me sipërfaqe të përgjithshme 27,323.0 ha, shpallet Peizazh i Mbrojtur tokësor/ujor", përfshihet në qarkun e Korçës dhe rrethin e Pogradecit....

...60 vjet më parë ...

...Ekonomia pyjore e Dajtit, në rrethin e Tiranës, me sipërfaqe 3,028.7 ha, u shpall "Park Kombëtar" me vendim të Këshillit të Ministrave nr.93, datë 16.02.1960. Njëherazi përfaqëson edhe Parkun e parë Kombëtar të Shqipërisë.

Në kuadër të studimit për krijimin e Rrjetit të Parqeve Kombëtar të Shqipërisë, me vendim të Këshillit të Ministrave nr.96, datë 21.11.1966, sipërfaqja e Parkut Kombëtar të Dajtit u zgjeruar me

3,300.0 ha.

Më pas, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.8906, datë 06.06.2002, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, ekosistemi natyrori Mali i Dajtit", me sipërfaqe 29,384.18 ha, i shtrirë në Qarkun e Tiranës dhe të Durrësit, me VKM nr.402, datë 21.06.2006, u rishpall "Park Kombëtar" me sipërfaqe të zgjeruar.

Më pas me VKM nr. 715, datë 23.06.2009, bazuar në studimin e kryer se në këto territore gjenden edhe komponente mineralogjike të tokave të *Vijon në faqe 5*

Vijon nga faqe 4

rralla si Vanadium, Galium, Germanium, Selen, etj, sipërfaqja e parkut kombëtar u zvogëluanë 29,216.89 ha.

Brenda kësaj sipërfaqe u përfshi dhe Rezervati Natyror i Menaxhuar (ish rezervati i gjuetisë) "Qafë Mollë-Derje" me sipërfaqe 3,458.0ha, miratuar me rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë nr.1, datë 27.07.1977. Me urdherin nr.404, date 25.1.1983 "Mbi caktimin e rezervateve të gjuetisë", sipërfaqja u ul në

3,300 ha.

Ish Drejtorja e Përgjithshme e Pyjeve dhe Shërbimit Pyjor, me rastin e shpalljes së të parit Park Kombëtar në Shqipëri (Mali i Dajtit, më 16 Shkurt 1960), vendosi dhe festoi disa herë që dita **16 Shkurt**, për çdo vit të jetë **"DITA E PARQEVE KOMBËTAR TË SHQIPËRISË"**, por kjo iniciativë u ndërpre pas vitit 2006.

26 Janari - Dita Botërore e Edukimi Mjedisor

Problemi i mbrojtjes së mjedisit dhe edukimit mjedisor është aq i rëndësishëm sa Dita Botërore e Edukimit Mjedisor festohet më shumë se një herë në vit. Kongresi Botëror i Edukimit Mjedisor (WEEC) bëhet në 14 tetor, por shumë organizata të tjera mjedisore e mbajnë edhe në 26 janar. Rezultatet e përpjekjeve tona për ta mbajtur mjedisin pastër do të jenë jetë-shkurtra nëse ne nuk i kushtojmë vëmendje mjaftueshëm edukimit mjedisor. Edukimi mjedisor është një fushë shumë-disiplinore që synon që të mësojë njerëzit dhe komunitetet se si njerëzit mund të kontrollojnë sjelljen dhe ekosistemet për të jetuar në mënyrë të qëndrueshme. Me fjalë të tjera, edukimi mjedisor është hartuar për të na mësuar se si të jetojmë në harmoni me natyrën dhe të zvogëlojmë ndikimin njerëzor në mjedis.

Lëvizja moderne për edukimin mjedisor fitoi njohje ndërkombtare dhe në një moment të rëndësishëm për shkak të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor që u zhvillua në Stokholm në qershor 1972. Në mbledhjen plenare të 21-të të Konferencës, u miratua e ashtuquajtura Deklaratë e Stokholmit. Dokumenti përmbante 26 parime në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Një nga parimet ishte "Edukimi mjedisor është thelbësor".

Detyra kryesore e Ditës Botërore të Edukimit të Mjedisit është të theksohet rëndësia e edukimit mjedisor si një disiplinë shkencore që i kushton vëmendje të veçantë dimensionit shoqëror të problemeve mjedisore dhe përqendrohet në krijimin e vetëdijes, njohurive, aftësive dhe motivimit për të adresuar, zgjidhur dhe parandaluar këto probleme.



27 Janari - Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar





Xhoni — PK Divjake - Karavasta © Foto INCA

Njoftime

26 Janar - Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

27 Janar - Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

2 Shkurt - Dita Botërore e Ligatinave

4 Shkurt - Dita e Krijimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura - AKZM

28 Shkurt - 2 Mars - Ditët Botërore të Energjisë së Rinovueshme

Për të lexuar Ditari Natyrës në vite ... <http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

1 - INTERNATIONAL MEETING ON MARINE RESEARCH 2020 - 16th and 17th of July, 2020

The **IMMR'20** is an international congress planned to discuss novel scientific knowledge on marine resources and research towards the sustainability of our planet. The scientific programme places under the spotlight innovative research in:

Aquaculture

Biodiversity, Conservation and Coastal Management

Blue Biotech

Fisheries and Management

Seafood Technology

More information can be found in www.immr.ipleiria.pt or by contacting immr@ipleiria.pt

IMPORTANT DATES

Deadline for abstract submission / April 06, 2020

Notification of acceptance / April 30, 2020

Deadline for early registration / May 31, 2020

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.


Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



Organizatat Partnerë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Ergi Petanaj